



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KUÇOVË
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT**

Data 09.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Produkte Ushqimore”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
(Ushqim për fëmijë), Kodi 15800000-6 (Produkte ushqimore të ndryshme), Kodi
15813000-0 (Ushqime për mëngjes)**

VLERA E FONDIT LIMIT :

Fond limit për 1 (një) vit : **5 414 600** (pesë milion e katërqind e katërmbydhjetë mijë e gjashtëqindë) **Lekë pa TVSH .**

Fond limit total për 2 (dy) vjet : **10 829 200**(*dhjetë milion e tetëqindë e njëzetë e nëntë mijë e dyqind*) **Lekë pa TVSH .**

Ref -81401-04-09-2026

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit pranë Bashkisë Kuçovë ka

hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimi/kualifikimit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

2.2.2 Vërtetim për xhiron mesatare vjetore për tre vitet e fundit ushtrimorë, të ketë një vlerë jo më të ulët se 30% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

2.2.3 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen për taksat vendore për vitin 2026, në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” kudo që operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve dhe xhiros mesatare është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

2.2.3 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen për taksat vendore për vitin 2025, në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” kudo që operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiscal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2021 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore " dhe në proporcion të drejtë me objektin e prokurimit, nga ku operatorët ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë vërtetimin për pagesën e vitit 2021 (i cili paguhet jo më vonë se data 20 janar të vitit pasardhës).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit ushtrimore duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme:

- Licencë të leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit Kodi II.1.A (1) Prodhim, përpunim shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz,
- Licencë të leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit Kodi II.1.B, Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz),

(nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe bazuar në Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet Në Republikën E Shqipërisë”, Shtojcë e ligjit "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", parashikohet:

Fusha II.

Ushqimi dhe Shëndeti

1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinarë

3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve
6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë
7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.
8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare

Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, parashikohet:

FUSHA II

USHQIMI DHE SHËNDETI

KATEGORIA II.1

PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregtimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategorori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË II.1.A

5. Licenca për veprimtaritë me kodin II.1.A jepet për çdo stabiliment ku kryhet veprimtaria.

6. Veprimtaritë e nënkategorisë II.1.A specifikohen në:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me kodin II.1.A.1.

b) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.2.

c) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që nuk përdoren për ushqim”, me kodin II.1.A.3.

7. Kriteret e posaçme të licencimit, dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategoritë II.1.A, përcaktohen në tabelën 1 .

Si dhe referuar Rekomandimit të përbashkët Nr.10181 Prot, APP dhe Nr. 8514 Prot, AKU, gërma "a" dhe "a.I" e seksionit III "Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim", ku përcaktohet se: "Ne hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë që:

a) Në objektet e prokurimit për prodhim/përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë Liçencë, kategoria II.1.A.1 "

Për sa më sipër, nisur nga argumentimi i njësisë së prokurimit si dhe referuar legjislacionit të fushës përkatëse, konstatohet se për veprimtarinë shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz) është i domosdoshëm **kodi II.1.B**, për Prodhim, përpunim shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz është i domosdoshëm **kodi II.1.A (1)**, si dhe për produkte bujqësore është i domosdoshëm **kodi II.1.C**.

Duke analizuar nga sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i miratuar është në proporcion me objektin e kontratës, llojin dhe specifikat e procedurës së prokurimit, si dhe produktet ushqimore që kërkon të prokurorë autoriteti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin me sukses kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 4 (katër) punonjës që të figurojnë në listëpagesat e shoqërise për të paktën muajn e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, ku nga këta 2 (dy) duhet të jenë shoferë të pajisur me lejet e drejtimit, si dhe 2 (dy) punonjës ndihmës të pajisur me librezat shëndetësore, për shpërndarjen e ushqimeve në ambjentet e caktuara prej autoritetit kontraktor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Numri prej **4 (katër)** punonjës është përlllogaritur referuar furnizimit të mallrave objekt prokurimi që do të kryejë operatori ekonomik fitues me qëllim realizimin e këtij shërbimi për një periudhën 24 mujore duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

Nisur dhe nga grafiku i lëvrimin të mallrave të hartuar nga Qendra Ekonomike e Arsimit si në vitet paraardhës, njësia e prokurimit gjykon se ka vendosur një numër minimal punonjësish dhe se, qëllimi i autoritetit kontraktor është zbatimi i kontratës me sukses dhe në kohë duke mos sjellë vonesa në lëvrimin e mallrave objekt prokurimit.

Zbatimi i kontratës është një sfidë më vete për autoritetin kontraktor, duke marrë parasysh faktin që produktet ushqimore do të përdoren për fëmijët e çerdheve dhe kopshteve të Bashkisë Kuçovë, dhe ku vonesa në lëvrimin e mallrave nuk mund të tolerohet. Gjykuar nga sa më sipër,

njësia e prokurimit vlerëson se ka kërkuar një numër minimal punonjësish që duhet të disponojnë operatorët ekonomik ofertues në përmbushje të zbatimit të kontratës.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik është e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor që 2 (dy) punonjës duhet të jenë me librezat shëndetësore së bashku me raportet mjeko-ligjore, njësia e prokurimit i është referuar Rekomandimit të përbashkët Nr.10181 Prot, APP dhe Nr. 8514 Prot, AKU, seksioni II "Hartimi i specifikimeve teknike për shërbimin e ushqimit social (për grupet e veçanta si spitale, **kopshte**, shkolla, reparte ushtarake IEVP, et", ku përcaktohet se: "Ne hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë që operatori ekonomik ofertues duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar, për furnizimin/ shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjedisit, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

Si dhe në të njëjtin seksion, pika (j), ku detyrohen operatorët ekonomik ofertues se punonjësit që do të shërbejnë produktet ushqimore duhet të jetë të pajisur ndër të tjera dhe me **librezë shëndetësore**.

Duke arsyetur që objekti i prokurimit është për furnizimin me produkte ushqimore për 4 (katër) kopshte dhe 3 (tre) çerdhe me drekë, njësia e prokurimit gjykon se numri i kërkuar i punonjësve të sipërcituar (shoferë dhe punonjës me librezë shëndetësore) është në përpjesëtim të plotë me objektin e kontratës dhe i shërbim njëkohësisht qëllimit të autoritetit kontraktor, duke garantuar këtë të fundit për zbatimin me sukses dhe në kohë.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 2 (dy) mjete transporti, nga të cilat 1 (nje) mjet transporti frigoriferik ATV për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (çertifikatë pronësie ose kontratë qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me lejen higjieno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe

pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri dhe lloji i mjeteve, pajisjeve në pronësi ose me qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar furnizimeve të mallrave sipas grafikut dhe kohëzgjatjes së kontratës. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Mjetet e kërkuar nga AK, të tipit ATV është bërë duke marrë parasysh kushtet në të cilat duhet të kryhet transporti i i produkteve të objekt prokurimi. Duke iu referuar Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, për transportin e këtyre produkteve kërkohen kushte frigoriferike, për rrjedhojë, automjetet kërkohet të jenë frigoriferikë, të tipit ATV. Nisur dhe nga sasia e lëvrimin të mallrave për një muaj, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal mjetesh transporti, në fuksion të zbatimit të kontratës me sukses dhe në kohë, duke mos sjellë vonesa në lëvrimin e tyre.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë dhe paraqesin çertifikatën sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht :

1. Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të autokontrollit, bazuar në parimet (**UNI 10854:99 HACCP**) *ose ekuivalent*.
2. **ISO 22000:2018** (Çertifikatë sipas konformitetit me standartet evropiane për menaxhimin e sigurisë ushqimore) *ose ekuivalent*.
3. **ISO 9001:2015** (Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë) *ose ekuivalent*.

Argumentim: Në bazë të dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i

plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrueshëm me avantazhe reciproke.

– **Çertifikatë per sistemin e menaxhimit te autokontrollit, bazuar në parimet UNI 10854:99 H.A.C.C.P. ose ekuivalent**

L HACCP është një sistem vetë-kontrolli higjienik për ushtrime publike dhe për industri ushqimore.

Siguron që menaxheri i ndërmarrjes ushqimore duhet të sigurojë që përgatitja, shndërrimi, prodhimi, paketimi, ruajtja, transporti, shpërndarja, trajtimi, shitja ose furnizimi, përfshirë administrimin e produkteve ushqimore, të kryhen në një mënyrë higjienike.

Standardi UNI 10854: 1999 është dokumenti kombëtar i referencës për krijimin e një sistemi të menaxhimit të vetë-kontrollit bazuar në metodën HACCP (Analiza e rrezikut dhe pika kritike e kontrollit).

Kjo metodologji është sot më e përhapura për vlerësimin e rreziqeve dhe rreziqeve që lidhen me sigurinë higjienike të produkteve dhe proceseve dhe për krijimin e masave adekuate të kontrollit.

Nisur nga objekti i kontratës i cili është “Blerje ushqimore” kërkesa e mësipërme e njësisë së prokurimit është në përpjestim dhe vëllim të plotë me procedurën e prokurimit .

• **Çertifikatë EN-ISO 22000:2018 ose ekuivalent**

Çertifikata ISO 22000: 2018 specifikon kërkesat për një sistem të administrimit të sigorisë ushqimore, ku një organizatë në zinxhirin ushqimor duhet të tregojë aftësinë e saj për të kontrolluar rreziqet e sigorisë ushqimore në mënyrë që të sigurojë që ushqimi të jetë i sigurt në kohën e konsumit të njeriut.

Është i zbatueshëm për të gjitha organizatat, pavarësisht nga madhësia, të cilat janë të përfshirë në çdo aspekt të zinxhirit ushqimor dhe duan të zbatojnë sisteme që ofrojnë vazhdimisht

produkte të sigurta. Mjetet për të përmbushur çdo kërkesë të ISO 22000: 2018 mund të arrihet përmes përdorimit të burimeve të brendshme dhe / ose të jashtme.

ISO 22000: 2005 specifikon kërkesa për të mundësuar një organizatë

- të planifikojë, zbatojë, funksionojë, mirëmbajë dhe azhurnojë një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore që synon të sigurojë produkte që, sipas përdorimit të tyre të synuar, janë të sigurta për konsumatorin,
- të demonstrojë pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore të sigurisë së ushqimit,
- të vlerësojë dhe vlerësojë kërkesat e klientit dhe të demonstrojë përputhshmëri me ato kërkesa të konsumatorëve të rënë dakord reciprokisht që kanë të bëjnë me sigurinë ushqimore, me qëllim të rritjes së kënaqësisë së klientit,
- të komunikojnë në mënyrë efektive çështjet e sigurisë ushqimore furnitorëve të tyre, klientëve dhe palëve përkatëse të interesuara në zinxhirin ushqimor,
- të sigurohet që organizata të jetë në përputhje me politikën e saj të deklaruar për sigurinë e ushqimit,
- të demonstrojë një konformitet të tillë me palët e interesuara përkatëse, dhe
- të kërkojë vërtetimin ose regjistrimin e sistemit të tij të administrimit të sigurisë ushqimore nga një organizatë e jashtme, ose të bëjë një vetëvlerësim ose vetë-deklarim të konformitetit me ISO 22000: 2018.

Disponimi i kësaj çertifikate nga ofertuesit është i nevojshëm dhe në përputhje me objektin e kontratës , garanton njëkohësisht autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses, në kohë si dhe me cilësi.

- **ISO 9001 - 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel nderkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë) . Çertifikata e menaxhimit të cilësisë është primare në produktet ushqimore të kërkuar nga AK .

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kërkesat e mësipërme janë në përpjestim dhe përputhje të plotë me objektin e kontratës, për sa kohë i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor.

2.5 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin:

2.5.1 Magazine ushqimore në pronësi/me qera ose në përdorim sipas kontratës noteriale, ku sipërfaqje totale për ambientin të jetë jo më pak se 50 m² të pajisur me:

- **Licensë nga QKL me kodin II.1.B**
- **Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri**
- **Akt-miratim higjeno sanitar**
- **Raport analizën e ujit të rrjetit**
- **Çertifikatën e dezinfektimit 3D**
- **Si dhe foto të ambjenteve të ushtrimit të aktivitetit.f**

Plotësimi i kriterit të mësipër nga operatorët ekonomik ofertues i krijon garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, duke mos sjellë vonesa në lëvrimin e produkteve ushqimore. Duke parë dhe preventivin e ushqimeve si dhe grafikun e lëvrimin ku kërkohen produkte ushqimore, bulmete, si dhe mish viçi, etj, kërkesat e mësipërme për magazinë ushqimore dhe ambiente frigoriferike janë në përputhje me objektin e prokurimit, duke garantuar autoritetin kontraktor për cilësinë e ushqimeve që të jenë të freskëta sipas normave dhe rregullave në fuqi, duke marrë në konsideratë dhe faktin që të gjitha produktet ushqimore do të jenë per kopshtet dhe çerdhet .

Si dhe referuar Rekomandimit të përbashkët Nr.10181 Prot, APP dhe Nr. 8514 Prot, AKU, gërma "d" e seksionit III "Hartimi i kriterëve të vecanta për kualifikim", ku përcaktohet se: "Në hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim, autoriteti kontraktor duhet të mbaje në konsideratë qe: d. Operatori ekonomik të ketë në pronësi/qera ose në përdorim ambiente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuar për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambientet e kërkuar duhet të plotësojnë kushtet higjeno sanitare ".

2.5.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë në pronësi ose në përdorim ose me kontratë furnizimi noteriale **Furrë buke** të pajisur me çertifikatë pronësie, me leje higjeno sanitare, licensë QKL me Kodin II.1.A.(1) si dhe Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri.

Për produktin e mësipërm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/me qera ose kontratë përdorimi duhet që të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi/ ose kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: liçensë, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

2.5.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë në pronësi **ose** në përdorim **ose** me kontratë furnizimi noteriale **Thertore** të pajisur me leje higjieno sanitare, Leje mjedisore me kodin III.1.B (therje kafshësh), Liçensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) me kodin II.1.A.(1) (thertore).

Për produktin e mësipërm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/qera ose në përdorim duhet që të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi/ ose kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si liçensë, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

2.5.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë në pronësi **ose** në përdorim **ose** me kontratë furnizimi noteriale **Kompleks stallor** të pajisur me çertifikatë pronësie, Leje mjedisore me kodin III.1.B (mbarështim kafshësh), Liçensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) me kodin II.3.A dhe II.3.C.

Për kompleksin stallor në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/me qera ose kontratë përdorimi duhet që të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi/ ose kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: liçensë, telefon, email, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

2.5.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë në pronësi **ose** në përdorim **ose** me kontratë furnizimi noteriale **Kompleks pularie** të pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) me kodin II.1.A.1 (prodhim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë të vezëve), Kodi 11.1.B (Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (vezë). Për kompleksin e pularisë në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/me qera ose me kontratë përdorimi duhet që të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi/ ose kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: liçensë, telefon, email, website, etj., kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

2.5.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë në pronësi ose në përdorim ose me kontratë furnizimi **Njësi prodhimi bulmeti** të pajisur me çertifikatë pronësie, si dhe të shoqëruar me leje higjieno sanitare, leje mjedisore me kodin III.1.B (për trajtimin dhe përpunimin e qumështit, Licensë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me kodin II.1.A.(1) dhe II.1.B Për produktin e mësipërm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/me qera ose me kontratë përdorim duhet që të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi/ ose kontratë furnizimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: liqensë, telefon, email,website, etj., kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

2.6 Operatorët ekonomik ofertues duhet të operojnë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ata duhet të **paraqesin vetëdeklarim** ku të deklarojnë se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacion provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën me sukses dhe në kohë.

Njësia e prokurimit mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke analizuar preventivin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi, parashikohen ato zëra ku disponueshmeria e **Magazinës ushqimore dhe ambiente frigoriferike, Thertores, Kompleks stallor, Furrë buke, Serë, Kompleks pularie dhe Njësi prodhimi bulmeti** lidhet drejtëpërdrejtë me zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë si dhe me preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor, duke garantuar këtë të fundit për vazhdimësinë e tyre në mënyrë të pandërprerë.

Autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, është në të drejtën e tij të kërkojë nga ofertuesit në lidhje me kapacitetin e tyre teknike për përmbushjen me sukses të zbatimit të kontratës, dhe për rrjedhojë të kërkojë garanci nga operatorët ekonomik për mënyrat se si do furnizohet AK për çdo zë të parashikuar tek preventivi i furnizimit të mallrave objekt prokurimit.

Nisur nga sa më lart, si dhe bazuar në preventivin e mallrave objekt prokurimit, vërehet se për 1 vit kalendarik janë parashikuar 13000 vezë, ku disponimin i **Kompleks pularie** nga ofertuesit në një nga format sipas ligjit në fuqi në pronësi/me qera, në përdorim ose me kontratë furnizimi, garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses

Për Njësi prodhimi bulmeti në pronësi/me qera, në përdorim ose me kontratë furnizimi, janë parashikur për 1 vit kalendarik 6200 kg qumësht.

Për Furrë buke në pronësi/me qera, në përdorim ose me kontratë furnizimi, janë parashikur për 1 vit kalendarik 3300 kg bukë.

Për Kompleks stallor dhe Thertore në pronësi/me qera, në përdorim ose me kontratë furnizimi, janë parashikur për 1 vit kalendarik 1200 kg mish viçi.

Për Serë për prodhimin e perimeve të freskëta në pronësi/me qera, në përdorim ose me kontratë furnizimi janë parashikur për 1 vit kalendarik mallra si patate, spinaq, lakër, presh, domate g, specia, patëllxhan, bamje, qepe e thatë g, bizele, mashurka, kungull, sallator, fasula, thjerza etj.

Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht:

“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”.

Ky ligj përcakton:

a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”

Në neni 4 “ Sistemi i lejeve të mjedisit ” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, parashikohet shprehimisht:

“1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:

a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/A të këtij ligji;

b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/C të këtij ligji.”

Në shtojcën 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, përcaktohet:

“Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të

njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mblidhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo”.

Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, parashikohetsi më poshtë:

Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon:

- Leje Mjedisi e Tipit C me kodin III.1.A
- Leje Mjedisi e Tipit B me kodin III.1.B
- Leje Mjedisi e Tipit A me kodin III.1.C

Në ligjin Nr. 60/2014 “Për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, Datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, parashikohet :

SHTOJCA 1 LEJET E MJEDISIT TË TIPAVE A, B DHE C NË VARËSI TË KAPACITETIT PRODHUES KUFI SHËNIME PËR TABELËN E VEPRIMTARIVE TË TIPIT B

Sa me sipër, njësia e prokurimit gjykon se, kërkesat e vendosura se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në rast se janë thertore, duhet të paraqesin Leje Mjedisi të tipit B, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, (të ndryshuar), është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore si të Ligjit Nr. 60/2014 “Për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, Datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”.

Plotësimi i kriterit të mësipër nga operatorët ekonomik ofertues i krijon garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, duke mos sjellë vonesa në lëvrimin e produkteve ushqimore.

Akoma më tej njësia e prokurimit e ka lënë të hapur plotësimin e kriterit të mësipërm për sa kohë që provohet disponueshmëria e tyre në një nga format sipas legjislacionit në fuqi.

2.6 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin rregjistrat e monitorimit të temperaturave për periudhën e vitit 2021 për frigoriferët e instaluar në ambientet e ushtrimit të aktivitetit sipas Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë Nr. 22 datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjenës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon që

operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën me sukses dhe në kohë.

Në Kapitullin IX

Dispozita të zbatueshme për produktet ushqimore, pika 5 parashikohet se :

Lëndët e para, përbërësit, produktet gjysmë të gatshme dhe produktet e gatshme që favorizojnë riprodhimin e mikroorganizmave patogjenë ose formimin e toksinave nuk ruhen në temperatura që mund të shkaktojë rrezik për shëndetin. **Zinxhiri ftohës nuk ndërpritet.** Megjithatë, periudha të kufizuara jashtë kontrollit të temperaturës lejohen për të mundësuar procesin e trajtimit gjatë përgatitjes, transportit, ruajtjes, reklamimit dhe shërbimit të ushqimit, duke u siguruar që kjo nuk shkakton rrezik për shëndetin. Bizneset ushqimore të prodhimit, trajtimit dhe paketimit të produkteve ushqimore të përpunuara kanë ambiente të përshtatshme, të një madhësie të mjaftueshme për ruajtje të veçantë të lëndës së parë nga materialet e përpunuara dhe hapësirë të veçantë për ruajtje frigoriferike.

Si dhe referuar Rekomandimit të përbashkët Nr.10181 Prot, APP dhe Nr. 8514 Prot, AKU, pika 1.2, gërma f) "Hartimi i specifikimeve teknike për produktet ushqimore".

2.7 Operatorët ekonomik ofertues duhet të operojnë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ata duhet të **paraqesin vetëdeklarim** ku të deklarojnë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacion provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën me sukses dhe në kohë.

Si dhe referuar Rekomandimit të përbashkët Nr.10181 Prot, APP dhe Nr. 8514 Prot, AKU, gërma "g" e seksionit III "Hartimi i kriterëve të vecanta për kualifikim", ku përcaktohet se: "Në hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim, autoriteti kontraktor duhet të mbaje në konsideratë që: Duhet plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të

paraqesi vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli I fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet conform kërkesa ligjore.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim, si dhe do të veprohet konform parashikimeve të LPP.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

- **Specifikime te bukes**

Të jetë cilësore e butë dhe të jetë e prodhuar brenda 24 orëve.

Të plotësojë parametrat fiziko kimik normal si të miellit dhe të bukës.

Të ketë rrezen 70%.

Pavarësisht sasisë së bukëve llogaritja do të bëhet në kg..

Furnizimi do të bëhet çdo mengjes sipas kërkesës së bërë një ditë më para.

- **Specifikimet e ushqimeve (koloniale)**

Mielli të jetë i cilësisë së parë i bardhë pa pastërti me rreze 0. Të jetë i pakëtuar me pako 1 kg.

Orizi të jetë i cilësisë së para i rrumbullakët i bardhë. Të jetë i paketuar me pako 1 kg ose me thasë 25-50 kg.

Sheqeri të jetë me ngjyrë të bardhë i cilësisë së parë i pakeluar me pesë 1 kg ose me thasë 25-50 kg.

Vaji të jetë me stampen përkatëse dhe të jetë i përshtatshëm, me peshë 1 kg.

Salca e domates të jetë e cilësisë së parë e trashë me kuti metalike ose në shishe qelqi 700 gr.

Makaronat të jenë të cilësisë së parë të formave të ndryshme edhe për supë me peshe 0.5 ose 1 kg.

Reçeli të jetë Qershie molle ose fiku i cilësisë së parë me ambalazhim 1 kg.

Marmalata e fikut të jetë e cilësisë së parë me ambalazhim 1 kg.

Niseshteja të jetë e cilësisë së parë me pako 1 kg ose me thasë 25 kg.

Kripa të jetë cilësore e bardhë e pastër e pakeluar në qeska 0.5 – 1 kg.

Piperi i zi të jetë i pakeluar me pjesë 15 gr.

Fasulet të jenë të bardha pa dëmtime dhe lëndë të huaja, të pakeluara në qese 1 kg ose thas deri 50 kg.

Thjerrëzat të jenë të pastra pa lëndë të huaja në paketim 1 kg.

Biskotat të jenë të embla për çaj me afat skadence mbi 6 muaj, në paketim 300 gr.

Çokokremi të jetë cilësor dhe me afat skadence mbi 6 muaj, në paketim 1 deri 2.5 kg.

Kakao të jetë e cilësisë së lartë, në paketim 1 kg.

- **Specifikime teknike te bulmetit**

Qumshti të jetë lope i fresket i mjelë brenda ditës

Të ketë densitet normal

Të përmbajë aciditet normal

Të ketë lëndën e thatë në sasi normale

Të përmbajë yndyre der ne 3.5 %

Të ketë ngarkesë mikrobike 0.

Qumështi do të vijë në shishe 1.5 l dhe me afat prodhime dhe skadence.

- **Specifikime teknike te gjalpfit.**

Të jetë i stazhionuar.

Të mos përmbaje aciditet.

Të ketë densitet normal.

Të jetë i cilësisë parë i fresket duke përcaktuar parametrat përkatës.

Të ketë përmbajtje kripe normale.

- **Specifikime teknike per djathin.**

Të ketë lagështi ose lëndë të thatë 48%

Të jetë cilësi e parë me yndyre 30-60%.

Të përmbajë jo me shumë se 4% kripe.

Të jetë i ruajtur në kushte normale higjieno sanitare.

Të ketë fortësi në përbërje.

Të përmbajë parametrat normal sipas standarteve të AKU.

Të jetë i shoqëruar me certifikatë veterinare dhe analiza fizike kimike e mikrobike nga Drejtoria e Bujqësisë e Ushqimit.

- **Specifikime teknike te mishit.**

Të jetë i fresket i kulluar dhe jo i ngrirë.

Indi muskolor të jetë ngjyrë roze.

Të jetë i shoqëruar me raport veterinar original ku të jenë të shënuar edhe data e therjes, cilësia e lloji i mishit.

Mishi të jetë i shoqëruar me vulën e njomë të veterinerit për çdo kontigjente apo pjesë të shkëputur.

Përmbajta e azotit amoniakal të jetë 8-14 %.

Esherika Coli dhe Cisticercuk bovis të mungojë në çdo gr produkt pra infeksioni të jetë 0.

Ngjyra e mishit të jetë e çelët dhe pa dhjam.

Të ketë garanci veterinare.

Hyrja në magazinë do të bëhet sipas kërkesës së bërë një ditë më parë.

- **Specifikimet teknike te fruta – perimeve.**

Të jenë të cilësisë së parë.

Të jenë të fresketa duke respektuar konvejerin e gjelbër të stinës dhe të mos jenë të konservuara.

Furnizimi do të bëhet çdo ditë sipas kërkesave.

Malli të jetë i sistemuar në amballazhet përkatëse.

- **Vezet të jenë të fresketa me afat prodhime dhe skadencë si dhe të vulosura nga prodhuesi.**

NJËSIA E PROKURIMIT